VENDIM
Nr. 792, datë 24.12.2025

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR KRIJIMIN, VENDOSJEN NËN MBIKËQYRJE, PEZULLIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUTEVE DHE TË NJËSIVE TË VEÇANTA TË KËRKIMIT SHKENCOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 16, dhe të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 109/2024, "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e kritereve, të rregullave dhe të procedurave për krijimin e instituteve dhe të njësive të veçanta publike të kërkimit shkencor, si dhe për vendosjen nën mbikëqyrje, pezullimin dhe mbylljen e çdo instituti dhe njësie të veçantë të kërkimit shkencor, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së kërkimit shkencor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Instituti privat i kërkimit shkencor dhe njësia e veçantë private e kërkimit shkencor krijohen sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për personat juridikë privatë.

3. Instituti i kërkimit shkencor dhe njësia e veçantë e kërkimit shkencor kanë si mision nxitjen e dijes e të së vërtetës shkencore, mbrojtjen e shëndetit publik, të trashëgimisë kulturore, mjedisore e materiale, nxitjen e teknologjisë dhe inovacionit, nëpërmjet kryerjes së veprimtarive laboratorike dhe vlerësimeve shkencore në këto fusha.

4. Instituti i kërkimit shkencor ka për objekt kërkimin shkencor e zbatimin e tij në një apo në disa fusha të shkencës.

5. Njësia e veçantë e kërkimit shkencor realizon kërkim shkencor në fusha të veçanta të organizuara sipas legjislacionit në fuqi.

II. KRITERET PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE NJËSISË SË VEÇANTË PUBLIKE TË KËRKIMIT SHKENCOR

1. Instituti i kërkimit shkencor dhe njësia e veçantë e kërkimit shkencor krijohen sipas përbërjes, kritereve të organizimit dhe të plotësimit të personelit kërkimor shkencor, punonjësve ndihmëseteknikë dhe administrativë, të përcaktuar në ligjin nr. 109/2024, "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".

2. Instituti i kërkimit shkencor përbëhet nga jo më pak se dy njësi të kërkimit shkencor, të organizuara në formën e departamentit, qendrës kërkimore, laboratorit kërkimor ose qendrës eksperimentale. Personeli kërkimor shkencor i institutit, sipas kategorive, përbëhet nga të paktën:

a) 1 (një) kërkues shkencor i avancuar;

b) 4 (katër) kërkues shkencorë;

c) 2 (dy) asistentë kërkues shkencorë.

3. Personeli kërkimor-shkencor i njësisë së kërkimit shkencor, sipas kategorive, përbëhet nga të paktën:

a) 2 (dy) kërkues shkencorë;

b) 1 (një) asistent kërkues shkencor.

4. Numri dhe pozicionet e punës për punonjësit ndihmësteknikë dhe administrativë të institutit të kërkimit shkencor dhe njësisë së veçantë të kërkimit shkencor përcaktohen në aktet e brendshme të institutit apo të njësisë së veçantë, ku është punësuar punonjësi.

5. Instituti i kërkimit shkencor dhe njësia e veçantë e kërkimit shkencor duhet të plotësojnë kriteret infrastrukturore për krijimin e tyre, që lidhen me objektin ndërtimor, ku do të zhvillojnë veprimtarinë, i cili duhet të jetë i përshtatshëm për fushën/at e kërkimit shkencor, që do të realizojnë, si dhe të disponojnë infrastrukturën teknike të nevojshme, në përputhje me fushën/at, që t'i shërbejnë funksionimit normal të veprimtarisë kërkimore-shkencore.

6. Instituti i kërkimit shkencor dhe njësia e veçantë e kërkimit shkencor duhet të deklarojnë burimet e financimit dhe të garantojnë qëndrueshmërinë financiare për krijimin e tyre.

III. PROCEDURA PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE TË NJËSISË SË VEÇANTË PUBLIKE TË KËRKIMIT SHKENCOR

1. Çdo person juridik publik ka të drejtën e propozimit për krijimin e institutit ose të njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor.

2. Për krijimin e institutit ose të njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor ndiqen procedurat e mëposhtme:

a) Subjekti kërkues i paraqet dokumentacionin e nevojshëm ministrisë përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, për krijimin e institutit apo të njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor;

b) Propozimi për aplikim përmban informacionin dhe dokumentacionin, si më poshtë vijon:

i. kërkesën për krijimin e institutit apo të njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor, ku të përcaktohet misioni, objekti, fusha e veprimtarisë, duke argumentuar nevojën për krijimin e tij;

ii. të dhënat e subjektit, si dhe deklaratën/at për përbërjen, kriteret e organizimit e të personelit kërkimor-shkencor, si dhe të kritereve infrastrukturore;

iii. projektstatutin, i cili duhet të përmbajë normat bazë që rregullojnë veprimtarinë e institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, ku përcaktohen organizimi, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e organeve drejtuese, zgjedhja apo emërimi i tyre, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e tyre;

iv. projektdokumentin strategjik, që përcakton vizionin, objektivat afatgjatë, në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit 2023–2030;

v. deklaratën për burimet e financimit dhe të garantimit të qëndrueshmërisë financiare për krijimin e institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

3. Ministria përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, për verifikimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit mbi plotësimin e kritereve për krijimin e institutit ose të njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor, ngre një komision *ad hoc*, ku, në përbërje të tij, caktohen edhe ekspertë të fushës/ave të kërkimit shkencor, që zhvillon instituti apo njësia e veçantë e kërkimit shkencor, si dhe përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor.

4. Verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, bëhet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e aplikimit, sipas akteve të brendshme të ministrisë përgjegjëse, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore.

5. Ministria përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, i propozon Këshillit të Ministrave krijimin e institutit të kërkimit shkencor ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

6. Instituti i kërkimit shkencor apo njësia e veçantë e kërkimit shkencor i/e krijuar regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë.

IV. RREGULLA DHE PROCEDURA PËR VENDOSJEN NËN MBIKËQYRJE OSE PEZULLIM TË VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT DHE TË NJËSISË SË VEÇANTË TË KËRKIMIT SHKENCOR

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor kryen vlerësimin periodik apo vlerësime të tjera për verifikimin e përmbushjes së kritereve të funksionimit të institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

Për kryerjen e këtij vlerësimi, ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor dhe ministria përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore ngrenë një komision *ad hoc,* ku, në përbërje të tij, caktohen përfaqësues nga të dyja ministritë, si edhe ekspertë të fushës/ave të kërkimit shkencor, që zhvillon instituti apo njësia e veçantë e kërkimit shkencor.

2. Komisioni *ad hoc* ia paraqet raportin mbi vlerësimin e institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor ministrisë përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.

Në rast të konstatimit të mospërmbushjes së kritereve të funksionimit ose performancës së ulët në ushtrimin e veprimtarisë të institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, sipas kritereve dhe procedurave të vlerësimit të miratuara me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, komisioni i propozon ministrisë përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor vendosjen në mbikëqyrje ose pezullim të veprimtarisë kërkimore shkencore të institutit ose njësisë së veçantë.

3. Ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, bazuar në raportin e vlerësimit të komisionit, vendos:

a) kushte për vijimin e veprimtarisë nën mbikëqyrje të ministrisë deri në 1 (një) vit; ose

b) pezullimin e veprimtarisë deri në plotësimin e kushteve, për një periudhë jo më të gjatë se 2 (dy) vite kalendarike.

4. Në rast kur vendoset masa e përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 3, të këtij kreu, për monitorimin dhe raportimin mbi procesin e mbikëqyrjes së veprimtarisë së institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor dhe ministria përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore ngrenë një komision *ad hoc* me përfaqësues nga të dyja ministritë, si edhe ekspertë të fushës/ave të kërkimit shkencor, që zhvillon instituti apo njësia e veçantë e kërkimit shkencor.

5. Mbi bazën e raportit të vlerësimit të komisionit *ad hoc*, që monitoron procesin e mbikëqyrjes, ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor vendos, si më poshtë vijon:

a) Heqjen e kushteve, nëse konstatohet përmbushja e tyre brenda afatit të vendosur nga instituti ose njësia e veçantë e kërkimit shkencor nën mbikëqyrjen e ministrisë; ose

b) Pezullimin e veprimtarisë deri në 2 (dy) vite kalendarike, në rast se nuk janë plotësuar kushtet e vendosura për institutin ose njësinë e veçantë të kërkimit shkencor për vendosjen nën mbikëqyrjen e ministrisë.

6. Gjatë periudhës së pezullimit, instituti ose njësia e veçantë e kërkimit shkencor nuk lejohet të aplikojë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare, të financuara me fonde publike, apo të punësojë personel të ri kërkimor shkencor.

7. Në rast kur vendoset pezullimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore, në përfundim të afatit të përcaktuar, ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor dhe ministria përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, ngrenë një komision *ad hoc* me përfaqësues nga të dyja ministritë, si edhe ekspertë të fushës/ave të kërkimit shkencor, që zhvillon instituti apo njësia e veçantë e kërkimit shkencor për të vlerësuar përmbushjen e kushteve të vendosura.

8. Në rast se ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor konstaton përmbushjen e kushteve të vendosura prej saj, brenda afatit të përcaktuar në aktin e pezullimit,

vendos për heqjen e pezullimit dhe lejimin e ushtrimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

9. Në rast se kushtet e përcaktuara në aktin e pezullimit të ministrisë përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor nuk janë plotësuar brenda afatit të përcaktuar, ministria vijon procedurën për mbylljen e institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, sipas kreut V të këtij vendimi.

10. Subjekti i vendosur nën mbikëqyrje apo i pezulluar ka të drejtën e ankimit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative.

V. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR MBYLLJEN E INSTITUTIT OSE TË NJËSISË SË VEÇANTË TË KËRKIMIT SHKENCOR

1. Mbyllja e veprimtarisë së institutit ose të njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor dhe përcaktimi i detyrimeve pas mbylljes së tij/saj bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, mbi bazën e propozimit të ministrit përgjegjës për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor.

2. Veprimtaria e institutit ose e njësisë së veçantë të kërkimit shkencor mbyllet për rastet e përcaktuara në nenin 21 të ligjit për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.

3. Shkelje të rënda ligjore për mbylljen e institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor janë:

a) ushtrimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore, që shkakton rrezik për sigurinë kombëtare, të drejtat e njeriut, shëndetin publik apo mjedisin, mbi masën e normës së lejuar të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e jetës, sigurinë kombëtare, të drejtat e njeriut, shëndetin publik dhe mjedisin;

b) mosrespektimi i legjislacionit në fuqi për pronësinë intelektuale dhe shkelja e normave të etikës së kërkimit shkencor.

4. Për mbylljen e institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor respektohet, sipas rastit të paraqitur, procedura e mëposhtme:

a) Në rastin e mbylljes vullnetarisht të institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, subjekti paraqet propozimin e organit drejtues të institutit ose të drejtuesit të njësisë për njësinë e veçantë për mbyllje, propozim i cili përmban të dhëna për pasuritë publike të krijuara gjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore, të dhëna për menaxhimin e fondeve publike, si dhe për produktet shkencore, që disponon instituti ose njësia e veçantë e kërkimit shkencor;

b) Kur mbyllja e institutit ose e njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor bëhet për rastet e përcaktuara në nenin 21 të ligjit për shkencën dhe kërkimin shkencor, ministria përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, i propozon ministrisë përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor ndjekjen e procedurës ligjore për mbylljen e tij/saj.

5. Kur mbyllja e institutit ose e njësisë së veçantë të kërkimit shkencor publik bëhet për rastet e përcaktuara në nenin 21 të ligjit për shkencën dhe kërkimin shkencor, ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor i propozon Këshillit të Ministrave mbylljen e tij/saj.

6. Në rast të mbylljes së institutit privat apo të njësisë së veçantë private të kërkimit shkencor, ministria i propozon organit, që e ka krijuar, mbylljen e veprimtarisë së kërkimit shkencor, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për personat juridikë privatë.

7. Pas mbylljes vijohet procedura për çregjistrimin e institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor të mbyllur nga Regjistri Kombëtar i Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë.

8. Subjekti, për të cilin propozohet mbyllja, ka të drejtën e ankimit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative.

9. Instituti ose njësia e veçantë e kërkimit shkencor që mbyllet dorëzon dokumentacionin që disponon pranë arkivit shtetëror vendor, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.

VI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ngarkohen ministritë përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor, institutet e kërkimit shkencor dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku